

V E N D I M
Nr.34, datë 24.9.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Manol Konomi,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Franc Jakova,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, më datën 24.9.1996 shqyrtoi me nismën e saj në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.40 Akti.

O B J E K T I :

Kushtetueshmëria e nenit 16 të ligjit nr.8151, datë 12.09.1996 “Për ndryshime në Ligjin nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi e shqyrtoi çështjen,

V Ë R E N:

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, me nenin 16 të Ligjit nr. 8151, datë 12.9.1996 “Për ndryshime në Ligjin nr. 7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal” ka ndryshuar nenin 40 të Ligjit nr. 7573, datë 16.6.1992, duke zëvendësuar në paragrafët e parë dhe të dytë të tij, fjalët “Gjykata e Kasacionit” me fjalët “Gjykata Kushtetuese”, duke e përcaktuar këtë të fundit si organ që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për organet e pushtetit lokal.

Gjykata Kushtetuese konstaton se dispozita e nenit 16 të Ligjit të sipërpërmendur, i cili është një ligj i zakonshëm, vjen në kundërshtim me pikën 7 të nenit 24 të Ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, në të cilën përcaktohet në mënyrë taksative se Gjykata Kushtetuese “Zgjidh çështjet për ligjshmërinë e zgjedhjes së Presidentit të Republikës, të deputetëve si dhe të referendumit popullor, duke shpallur rezultatet përfundimtare”.

Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ndryshohen, ngushtohen ose zgjerohen, përveçse me ligj kushtetues.

Rrjedhimisht, Gjykata çmon se neni 16 i Ligjit nr.8151, datë 12.9.1996 “Për ndryshime në Ligjin nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal” duhet të shfuqizohet si antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24, 25 dhe 26 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I :

1.Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 16 të Ligjit nr.8151, datë 12.9.1996 “Për ndryshime në Ligjin nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”.

2. Neni 40 i Ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, mbetet siç ka qenë me këtë përmbajtje: “Kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të bëhet ankim në Gjykatën e Kasacionit brenda 3 ditëve nga shpallja e tyre.

Gjykata e Kasacionit shqyrton ankimin dhe brenda 3 ditëve jep vendimin e formës së prerë”.

3. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi të nesërmen e shpalljes së tij në Fletoren Zyrtare.

U shpall në Tiranë, sot më datë 24.9.1996